

UDHËZIM
Nr.1/2, datë 22.9.2008

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.1/1, DATË 13.2.2008 TË MINISTRISË
BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT DHE MINISTRISË
SË FINANCAVE “MBI ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
NR.10, DATË 4.1.2008 “PËR MBËSHTETJEN E PRODHIMIT BUJQËSOR””**

Në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.10, datë 4.1.2008 “Për mbështetjen e prodhimit bujqësor”,

UDHËZOJMË:

1. Në kreun II “Kriteret për të përfituar mbështetje, procedurat e aplikimit, përzgjedhjes, verifikimit dhe likuidimit të parave të përfituesit”, seksioni “A”, “Nëpërmjet mbështetjes së drejtpërdrejtë të buxheteve familjare”, bëhen këto ndryshime:

Në skemën “Prodhim vaj ulliri extra-vergine”:

Në aneksin I, te karakteristikat e vajit të ullirit, i virgjër, i cilësisë së lartë (Extra-vergine) pikat 1.1 b dhe 1.1 c ndryshojnë si më poshtë:

“b) Aroma: Karakteristikë e vajit të ullirit; pa aromë të huaj.

c) Shija: Karakteristikë e vajit të ullirit; pa shije të huaj.”.

Në skemën “Për ngritje të vreshtave, pemëtoreve dhe ullishtave”:

a) Në pikën 1 shtohet një fjali me këtë përmbajtje: “Periudha e aplikimit për fazën e dytë fillon në datën 20 shtator dhe mbaron më 20 tetor.”.

b) Fjalía e parë e pikës 10 ndryshon si më poshtë: “Vlerësimi i projekteve bëhet vetëm një herë në fund të muajit mars për fazën e parë dhe në fund të tetorit për fazën e dytë.”.

c) Në fund të aneksit III, të modelarit nr.4, shtohet një “Shënim” me këtë përmbajtje: “Në përputhje me prioritetet e rajonizimit të përcaktuara nga DRBUMK, do të mbështetet nga fondi për mbështetjen e prodhimit bujqësor specia “lajthi” dhe për rrethin e Sarandës “agrumet.”.

d) Pas pikës 22 shtohet pika 23 me këtë përmbajtje: “Mbështetja financiare e përfituesve të fazës së dytë do të kryhet vetëm pasi të likuidohen përfituesit e fazës së parë.”.

e) Në kreun II “Kriteret për të përfituar mbështetje, procedurat e aplikimit, përzgjedhjes, verifikimit dhe likuidimit të parave të përfituesit”, seksioni “B”, “Nëpërmjet kreditimit”, bëhen këto ndryshime:

Për skemën “Kompanitë që grumbullojnë, ruajnë dhe përpunojnë produkte bujqësore dhe blegtorale”.

a) Pika 1 ndryshon si më poshtë:

“1. Aplikimet për mbështetje financiare paraqiten pranë zyrës së bujqësisë, duke filluar nga data 1 mars deri më 30 maj për fazën e parë dhe nga data 1 tetor deri më datën 30 tetor për fazën e dytë, sipas formularit të kërkesës për aplikim (formulari nr.1)”.

b) Fjalía e dytë e pikës 7 ndryshon si vijon: “Afati i dërgimit të kërkesave pranë projektit 2 KR është data 10 qershor për fazën e parë dhe data 10 nëntor për fazën e dytë”.

c) Fjalía e parë e pikës 8 ndryshon si vijon: “Projekti 2KR, me mbarimin e afatit të aplikimit brenda muajit qershor për fazën e parë dhe nga 10-15 nëntor për fazën e dytë, bën vlerësimin e kërkesave të paraqitura dhe përzgjedhjen e subjekteve fituese”.

2. Ndryshimet e parashikuara në pikën 2 të këtij udhëzimi zbatohen edhe për skemën e mbështetjes “Për shoqëritë e prodhimit dhe të tregtimit për ndërtesa, makineri bujqësore, pajisje për ruajtje dhe përpunim të prodhimit” për pikat 5, 11 dhe 12”.

3. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I BUJQËSISË, USHQIMIT

MINISTRI I FINANCAVE

DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
Jemin Gjana

Ridvan Bode